

Standardi puro Serb me titull “**Rregullore për kërkesat teknike mbi njësitë e muraturës së argjilës, njësitë e muraturave silikate të kalciumit dhe blloqeve të baltës për sistemet e dysHEMEVE me rreze dhe blloqe**”.

Ky standard **9 faqësh**, përbëhet nga 16 artikuj ku përcaktohet: fushëveprimi, lloji i produktit të ndërtimit për të cilin zbatohet Rregullorja, përdorimi i synuar, karakteristikat thelbësore, procedura e vlerësimit dhe verifikimi i cilësisë së performancës, kontrolli i prodhimit të fabrikës, mënyra e marrjes së mostrave, metodat e provës lidhur me karakteristikat thelbësore, llojet e dokumenteve për vlerësimin dhe verifikimin e performances.

Rregullorja në fjalë përcakton kërkesat teknike për njësitë e muraturës së argjilës, njësitë e muraturave të silikatit të kalciumit dhe blloqeve të baltës për sistemet e dysHEMEVE me rreze dhe blloqe, në përputhje me standardet e harmonizuara që mbulojnë këtë fushë.

Afati i fundit për marrjen e komenteve është **28-11-2019**.

Ky njoftim realizohet në kuadër të njoftimit të operatorëve ekonomikë që mund të kenë interesa tregtare me shtetin serb lidhur me këtë kategori produktesh, të cilët mund të paraqesin komentet e tyre.